

**STATUTI**  
**SHOQERISE TREGTARE**  
**“MONTE-AL” SH.P.K.**

**Kreu 1**

**Dizpozita te pergjithshme**

Neni 1

Sipas kerkesave te ligjit numer 9901, date 14.04.2008 “Per tregtarët dhe shoqerite tregtare” dhe atij numer 9723, date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, krijohet shoqeria tregtare “MONTE-AL” Sh.p.k , e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe nenet e ketij statuti.

Neni 2

Ne kete statut termat e meposhtme kane keto kuptime:

Statuti: Statuti i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “MONTE-AL” Shpk

Shoqeria: Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar “MONTE-AL” Shpk

Ligji Tregtar: Ligji 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”

Në kuptim të këtij statuti, shprehjet në njëjës përfshijnë ato në shumës dhe anasjelltas me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës rezulton ndryshe. Përemri vetor “ai” përfshin edhe përemrin vetor “ajo” dhe përemrin vetor “ate”, nënkuptohen të dyja gjinitë me përjashtim te rasteve kur sipas kontekstit të dispozitës rezulton ndryshe.

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që shoqëria i drejton ortakëve sipas këtij statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen se janë kryer në mënyrë të rregullt kur dërgohen ortakëve në adresat e deklaruara prej tyre pranë administratorit të shoqerisë.

**Kreu 2**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia**

Neni 3

Sot, me 02.03.2022, une, themeluesi, kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin MONTE-AL Sh.p.k.

Themeluesi i shoqerie “MONTE-AL” Shpk eshte:.

- Z. Luis Haderi, i datelindjes 01.03.2001, i biri Eduardit, lindur ne Tirane dhe banues ne Rr. “Vaso Pasha”, Tirane, i pajisur me karte identiteti me nr leternjoftimi 033685277 nr Personal K10301064H.

Neni 4

Shoqeria do te kete statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

## Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- Tregtim me shumice e pakice, import-eksport i mallrave te ndryshme industriale dhe ushqimore, perfshire produktet dhe nenproduktet e cigareve, pijeve etj. Shitje me shumice dhe pakice e mjeteve te transportit te kapaciteteve te ndryshme qe sherbejne per transportin e mallrave dhe/ose te pasagjereve. Tregtim me shumice dhe pakice te te gjitha produkteve bujqesore, punime te ndryshme ne bujqesi (mbjellje, korrje,shirje etj), transport i produkteve bujqesore. Eksport-import, shitje me shumice dhe pakice e mjeteve bujqesore me ose pa zinxhire, te kapaciteteve te ndryshme, me ose pa rimorkio,makineri pajisje industriale. Eksport-import, shitje me shumice dhe pakice e te gjitha llojeve te pjeseve te kembimit, të reja dhe të përdorura per automjete te transportit tokesor, detar, ajror, gomave te automjeteve të transportit tokesor, ajror, dhe te mjeteve bujqesore, bateri te te gjitha llojeve. Import aksesoresh dhe elemente prodhime metalike, perpunimin dhe tregtimin e lendes se drurit etj. Hapje dhe shfrytezim i serviseve per riparimin dhe mirmbajtjen e të gjitha llojeve te mjeteve, tokesore, detare, ajrore, hapja pika lavazhi. Investime dhe sherbime ne fushën e pasurive të paluajtshme, duke përfshirë pa u kufizuar, shitje, qiradhenie, riparime, blerje, rimarrje te pasurive te patundshme në Shqiperi. Kontrolli teknik dhe periodik i automjeteve te kapaciteteve te ndryshme qe perdoren per transportin e pasagjereve ose te mallrave, te mjeteve bujqesore me ose pa zinxhire. Shitja me pakice e lendeve djegese(nafte,benzine,lubrifikante,etj). Administrimi i pikave te karburantit per shitje me pakice ne territorin shqiptar. Transporti i lendeve djegese brenda dhe jashte vendit me mjetet e shoqerise ose te treteve. Hapja dhe administrimi i pikave te karburantit dhe te mini-dyqaneve per tregtimin e aksesoreve te te gjitha llojeve te automjeteve. Aktivitet ne fushen e turizmit, hotelerise, bar, restorant. Import-eksport i mallrave te ndryshem industriale dhe ushqimore dhe perdorim shtepiak si, detergjente, tregtim i te gjitha materialeve, veshmbathje, tuba rekorderi, elektropompa si dhe mirembajtja e tyre etj. Tregtim me shumice dhe pakice,te pajisjeve kompjuterike te te gjitha llojeve. Tregtim pajisje elektrike dhe elektronike si dhe sherbimin per to. Zbatime punimesh ndertimi, konsulence, supervizion dhe kolaudim punimesh, design lulishtesh, furnitura fidanesh, mirembajteje pajisjesh, instalime teknologjike, dhe parqesh ekologjike te ndryshme, mirembajtje ambjentesh. Sistemime, transport kartotekash, dosjesh, arshivim dokumentacioni kartotekash. Planifikim, konsultim ne ndertim, mjedis, transport, infrastrukture, impiante teknike, procesimi i te dhenave ne fushat e lidhura me to, edhe te gjitha aktivitetet e tjera te cilat synojne t'i sherbejne direkt interesit te shoqerise. Pajisje dhe materiale kancelarie për përdorim personal dhe zyra. Import-Eksport dhe shitje të pajisjeve hidrosanitare, pllakave dhe materialeve hidraulike ( tubo, rakorderi, pompa uji, pajisje hidraulike për vaditje etj. ) për përdorim civil dhe industrial. Shitje e biletave për transport tokësor dhe ajror, kombëtar dhe ndërkombëtar. Import-eksport i mallrave të ndryshëm industrialë dhe ushqimorë dhe përdorim shtëpiak si : detergjentë, veshmbathje, aksesore etj. Tregtim me shumicë dhe pakicë të të gjitha produkteve bujqësore organike dhe inorganike, punime të ndryshme në bujqësi, transport i produkteve bujqësore. Import-eksport, pajisje elektrike, elektro-shtëpiake të të gjitha llojeve, tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm industrial, pastrim kimik Projektim, zbatime punime ndërtimi, konsulencë, supervizion dhe kolaudim punimesh. Prodhim dhe tregtime të materialeve të ndërtimit, prodhim dhe tregtimi i betoneve të ndryshme parafabrikate dhe elemente te ndërtimit, prodhimin e elementëve gjysëm fabrikat, prodhim dhe tregtim i dyerve dhe dritareve prej druri dhe duralumini, franksionimeve të zhavorreve, shpime me sondë etj. Veprimtari ne fushën e ndërtimit si ndërtime civile, ndërtime industriale, turistike, bujqësore,mallra dhe pajisje

elektrike, elektro-shtepiake te te gjitha llojeve etj. Veprimtari në fushën e turizmit, transportit, industrisë, në përpunimin e tregtimin e lëndëve djegëse etj. Shoqëria, brenda kufijeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar e financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj. Shoqëria mund të hapë veprimtari të reja, të krijojë sipërmarrje të reja ose të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera si brenda ashtu dhe jashtë vendit pa cënuar objektin kryesor të shoqërisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përcaktimi i normativave të harxhimit të karburantit, të vajit dhe ndërrimit të filtrave për automjete dhe gjeneratore. Vlerësim për nxjerrjen jashtë përdorimi të automjeteve te transportit.Import eksportsst, tregtim, mirembajtje te pajisjeve te kondicionimit(ngrohje, ftohje). Aktivitet ne fushen e reklames, ne fushen e botimeve te ndryshme si libra, gazeta, revista, CD dhe materiale te tjera publicitare. Prodhim, shperndarje dhe riprodhim reklamash.

Neni 6

Shoqeria e ka seline e saj ne: Rr. "Myslym Shyri", pall nr 46, shkalla 2, ap 16, Tirane.

Ajo mund te cele dhe adresa aktiviteti te tjera te dyta, dege e filiale ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.

Neni 7

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj pa afat.

Neni 8

Shoqeria ka vulen e saj.

### **Kreu 3**

#### **Kapitali**

Neni 9

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 500,000 (Peseqind mije) leke dhe perbehet nga 1 kuote me vlefte 500,000 leke. Pjesemarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

- Z. Luis Haderi, i datelindjes 01.03.2001, i biri Eduardit, lindur ne Tirane dhe banues ne Rr. "Vaso Pasha", Tirane, i pajisur me karte identiteti me nr leternjoftimi 033685277 nr Personal K10301064H, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 500,000 leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Te gjitha kuotat e kapitalit themeltar do te shlyhen me afat deri ne 3 vjet. Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre.

Neni 10

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet ose te zvogelohet sipas vendimit te ortakeve.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendime ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 11

Ortaku mund të transferojë të tretëve kuotat e tij të kapitalit pjesërisht ose tërësisht. Transferimi i kuotave tek të tretët do të bëhet vetëm pasi të ketë marrë vendim asambleja e ortakëve me shumicë absolute të votave.

Kuotat e kapitalit mund të fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes
- c) trashëgimisë
- d) dhurimit
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj

#### **Kreu 4**

#### **Organet vendimarrëse dhe drejtuese**

Neni 12

Organet e shoqërisë do të jenë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Fusha e veprimit, përberja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

#### **Asambleja e ortakëve**

Neni 13

Asambleja e ortakëve është organi më i lartë vendimor.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e ortakëve merr vendime sa herë e shihet të arsyeshme, por domosdoshmërisht për të miratuar pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.

Neni 14

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore, shpërndarjen e fitimeve dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

#### Neni 15

Asambleja e përgjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike te ortakeve. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e përgjithshme nuk eshte thirrur sipas paragrafit te mesiperem te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht kesaj parregullsie.

#### Neni 16

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e përgjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e përgjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme, vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votive, jane te pranishem personalisht.

Nese asambleja e përgjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

#### Neni 17

Asambleja e përgjithshme vendos me tri te katertat ( $\frac{3}{4}$ ) e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per:

- a) ndryshimin e statutit,
- b) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,
- c) miratimin e pasqyrave financiare vjetore
- ç) shperndarjen e fitimeve,
- d) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumice te votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- dh) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- e) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet ne QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### **Administrimi**

#### **Neni 18**

Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administrator te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet, me te drejte riprertitjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

#### **Neni 19**

Administratori ka te drejte te perfaqesoj shoqerine ne maredhenie me te tretet per permbushjen e aktivitetit te saj ne perputhje me nenin 5 te ketij statuti.

Organi Administrativ (administratori) ka te drejte dhe duhet te:

a) kryeje me mirebesim te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme e ortakeve e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi;

b) perfaqesoje shoqerine tregtare;

c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqerise;

ç) pergatit dhe nenshkruajne pasqyrat financiare vjetore, dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblesë se pergjithshme per miratim;

d) krijojte nje sistem paralajmërimi ne kohën e duhur per rrethanat, qe kercënojnë mbarëvajtjen e veprimtarise dhe ekzistencën e shoqerise;

dh) kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhënat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombëtare te Regjistrimit;

e) raportoje perpara asamblesë se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rëndësi te veçantë per veprimtarinë e shoqerise tregtare;

ë) kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

f) marre ne pune persona te ndryshem dhe rregullimin e maredhenieve te punes me ta.

g) perfaqesoje apo emeroje perfaqesues ne ceshtje gjyqesore qe mund te kete shoqeria ose ne ceshtje te tjera me pale te treta;

Nese asambleja e pergjithshme emerone me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine, pervec rasteve kur ne vendimin e emerimit shprehet ndryshe.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

#### **Neni 20**

- Administrator i shoqerise "MONTE-AL" emerohet Z. Luis Haderi, i datelindjes 01.03.2001, i biri Eduardit, lindur ne Tirane dhe banues ne Rr. "Vaso Pasha", Tirane, i pajisur me karte identiteti me nr leternjoftimi 033685277 nr Personal K10301064H. Afati i emerimit te administratorit do te jete 5 vjet nga data e miratimit te ketij statuti.

## **Kreu 5**

### **Kushtet ekonomike**

Neni 21

Shoqeria eshte pronare, disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjeter juridik ne Shqiperi; mund te bleje, te shese, te jape ne perdorim, etj.

Neni 22

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohen pasqyrat financiare sipas ligjeve ne fuqi. Pasqyrat financiare periodike mujore, tremujore, gjashtemujore miratohen e nenshkruhen nga administratori i shoqerise. Pasqyrat financiare vjetore nenshkruhen nga administratori dhe miratohen nga Asambleja e pergjithshme e Ortakeve.

Neni 23

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 24

Maredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republiken e Shqiperise. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykatën shqiptare.

## **Kreu 6**

### **Dizpozita te vecanta**

#### **Prishja – riorganizimi I shoqerise**

Neni 25

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe, per shkaqet:

- a) me vendim te Asamblese se Ortakeve per prishjen e shoqerise;
- b) ipas rasteve te parashikuara nga Ligji Tregtar;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) me vendim te gjykates;

Neni 26

Ne rastin e prishjes se shoqerise, Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje ose disa likuidatore.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj punonjesve, shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet Ortakeve.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person I interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 27

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Asamblese se pergjithshme te Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

### **Baza ligjore**

Neni 28

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare, Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter ne Republiken e Shqiperise.

Neni 29

Mosmarreshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te tretteve, zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert palet i drejtohen Gjykates se Republikes se Shqiperise per zgjidhje.

Neni 30

Ky statut u perpilua ne prani te ortakeve te shoqerise duke shprehur vullnetin e tyre te plote e te lire.

Ai u perpilua ne tre kopje me fuqi te barabarta secila, per t’u depozituar ne QKB, per t’u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Tirane me 02.03.2022

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**  
**“MONTE-AL” SHPK**

**Luis HADERI**

